

VENDIM
Nr.2, datë 20.1.2010

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN
E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, e 9, dhe nenit 45, pikat “3” dhe “4” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “f”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.85, datë 04.11.2009.

- Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike është paraqitur i plotë, konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike me afat të vlefshmërisë së licencës 5 vjet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta